




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK. Nr. 465/2022**

**Datë: 24 nëntor 2022**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 9, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur për rastin e evidentuar Nr.AD/KGJK/06/2022, ndaj z.Mustaf Tahiri, Kryetarë në Gjykatën Themelore në Ferizaj, sipas ankesës së ushtruar nga “Lunari Compani”, me datë 26 tetor 2022, në mbledhjen e 299-të, të mbajtur më datë 24 nëntor 2022, nxjerr:

## **V E N D I M**

**Hudhet si e pa lejuar**, ankesa e “Lunari Compani”, Sh.P.K, fsh. Komogllavë, komuna Ferizaj, e paraqitur kundër vendimit të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, ADGJTHFR.nr.11/22/26/22, të datës 17 tetor 2022.

## **A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, (në vijim “Këshilli”) me datë 3 nëntor 2022, me akt përcjellës përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj, ka pranuar ankesën e “Lunari Company”, Sh.P.K, fsh. Komogllavë, komuna Ferizaj, të ushtruar kundër vendimit të Autoritetit Kompetent respektivisht Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, z.Mustaf Tahiri, të evidentuar ADGJTHFR.nr.11/22, me të cilin vendim është refuzuar si e pa bazuar ankesa e “Lunari Company”, e ushtruar ndaj gjyqtarit Faton Ajvazi.

Ankuesi në këtë çështje disiplinore ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që ta shqyrtoj vendimin e Autoritetit Kompetent përkatësisht të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të evidentuar ADGJTHFR.nr.11/22, të datës 17 tetor 2022, pasi që përkundër që i është refuzuar si e pa bazuar ankesa disiplinore ndaj gjyqtarit Faton Ajvazi, Autoriteti Kompetent nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve dhe se i njëjti vendim nuk përmban këshill juridike.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24 nëntor 2022, pasi shqyrtoi dhe vlerësoj pretendimet ankimore të vendimit të ankimuar, në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 dhe 7, të Ligjit për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka gjetur se:

Ankesa e ushtruar kundër vendimit ADGJTHFR.nr.10/22, të datës 13 tetor 2022, e parashtruar nga “Lunari Company” **është e pa lejuar**.

Në këtë drejtim, Ligjit Nr.06/L-057, Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, i ka dhënë mundësin secilit person fizik dhe juridik që të parashtoj ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoritet Kompetent, mirëpo nuk ja ka dhënë mundësin ligjore personave fizik dhe juridik që të parashtrojnë ankesë ndaj vendimit të Autoritetit Kompetent tek Këshilli kur Autoriteti Kompetent e ka refuzuar ankesës disiplinore, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit.

Në këto rrethana, Këshilli duke vlerësuar ankesën e parashtruar së bashku me shkresat e bashkangjitur sa i përket pretendimeve ndaj vendimit ADGJTHFR.nr.11/2022, të datës 17 tetor 2022, të nxjerr nga Autoriteti Kompetent përkatësisht Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj z.Mustaf Tahiti, konstatohet se ankesa **është e pa lejuar**.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.465/2022, datë 24 nëntor 2022**

Albert Zogaj  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- “Lunari Company”, SH.P.K, me seli ne Komogllavë, komuna e Ferizaj;
- Mustaf Tahiri, Kryetar, Gjykata Themelore ne Ferizaj;